



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2640/16 Prot.

Tiranë, më 17.10 2023

V E N D I M

Nr. 73 datë 17.10 2023

“PËR

**EMËRTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË FORMIMIT TË VAZHDUAR NË FUSHËN PSIKO-PEDAGOGJIKE, SIPAS URDHËRIT TË MAS DHE MIRATIMIN E TARIFËS SË APLIKIMIT, TARIFËS SË RREGJISTRIMIT, TARIFËS SË SHKOLLIMIT, PËR KËTË PROGRAM”**

Në zbatim të nenit 3, pika 2 gërma b, nenit 49 , pika d), nenit 81 të ligjit nr.80/2015 ” Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr.57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të vecantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, Udhëzimit të MAS nr.3, datë 15.02.2023 “Për përcaktimin e diplomave universitare të njëvlershme, të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndët e mësimdhënies në Arsimin Parauniversitar dhe kriteret për hapjen e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike” i ndryshuar, Urdhërit nr.374 datë 14.07.2023 të MAS “Për hapjen e programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike, në UST” , nenit 43 të Statutit të UST-së, nenit 24 të Rregullores së Universitetit të Sporteve të Tiranës, si dhe shkresat e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes nr.2491 Prot., datë 05.10.2023 “Përcjellje për miratim e “Programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike” në FSHL dhe nr.2586/1 prot.datë 12.10.2023 “Përcjellje e propozimit për tarifën e shkollimit për “ Programin e studimit të formimit të vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike”, në Vendimin e Rektoratit nr. 107. Datë 16.10.2023, në Vendimin Qarkullues të Senatit Akademik me nr.113 datë 16.10.2023, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 17.10.2023,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e emërtimit të programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike në edukimin fizik, sport dhe shëndet, në fakultetin e Shkencave të Lëvizjes, të UST-së, “Programi i Studimit të formimit të vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike” sipas, Urdhërit nr.374 datë 14.07.2023 të MAS “Për hapjen e programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike, në UST”

2. Miratimin e tarifës së aplikimit, rregjistrimit dhe të tarifës së shkollimit për këtë program, sipas tabelës bashkëlidhur.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi Administratori i Universitetit të Sporteve të Tiranës, Fakulteti i Shkencave dhe të Lëvizjes, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore,
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al) dhe tek transparenca universitare.

**KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

P/



ARTUR ÇOBANI

REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
TIRANË  
UNIVERSITETI I SPORTIT

*Artur Çobani*

Fakulteti Shkencave të lëvizjes

|                       |            |
|-----------------------|------------|
| Tarifa e aplikimit    | 2.500 lekë |
| Tarifa e regjistrimit | 2.000 lekë |

| Emërtimi i Programit  | Tarifa (ne lekë) për 35 kredite në lekë |
|---|---|
| Programi i studimit të formimit të vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike | 35.000                                  |